



- Të Reja ▾Policia e Shtetit ▾Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptarShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjet e policisëVideo
- Programi i transparencës ▾KontaktDenonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore të Policisë ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾
- DonacioneRubrika Policimi në Komunitet ▾Përmbledhja JavorePër sinjalizimin

Breaking News: Përmet/I vodhi celularin një shtetasi italian, falë veprimeve të shpejta nga Policia, identifikohet, kapet dhe vihet në pranga autori i dyshuar Policia e Shtetit – Bllokohen 11 mjete të tjera lundruese

Sarandë/Kundërshtuan punonjësit e Policisë dhe i penguan ata për kryerjen e detyrës, vihen në pranga 2 shtetas (vëllezër), njëri prej tyre i shpallur në kërkim Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Kodra e diellit” Policia e Shtetit/Njoftim për aplikimet në Akademinë e Sigurisë



28/08/2023

Tiranë – Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Kodra E Diellit”

Tiranë

Finalizohet nga Komisariati i Policisë Nr. 1, në bashkëpunim me Sektorin e Forcës së Posaqme “Shqiponja”, operacioni policor i koduar “Kodra e diellit”.

Nuk iu bind urdhrit të punonjësve të Policisë, për të ndaluar automjetin, hodhi në tokë një armë zjarri pistoletë dhe u largua, identifikohet dhe shpallet në kërkim 27-vjeçari.

Sekuestrohet arma e zjarrit pistoletë.

Procedohen në gjendje të lirë 2 shtetas që qarkullonin me një automjet tjetër.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 1, në bashkëpunim me Sektorin e Forcës së Posaqme “Shqiponja”, në vijim të punës për goditjen e paligjshmërive, bazuar në informacionet e siguruara në rrugë operative, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar “Kodra e diellit”.

Gjatë operacionit, te Kodra e Diellit, shërbimet e Policisë kanë lokalizuar dy automjete të cilave iu kanë bërë shenjë ndalimi, por drejtuesit e tyre nuk iu janë bindur urdhrave dhe kanë tentuar të largohen. Njëri prej tyre ka braktisur automjetin dhe është larguar me vrap duke hedhur në tokë një armë zjarri pistoletë, ndërsa drejtuesi tjetër është kapur dhe ndaluar bashkë me pasagjerin.

Në vijim të veprimeve, u identifikua dhe u shpall në kërkim drejtuesi që braktisi automjetin, shtetasi A. I., 27 vjeç, banues në Laç. Vijon puna për kapjen e tij.

Gjithashtu, nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin E. P., 27 vjeç, banues në Laç, për veprën penale “Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësve të policisë”, pasi nuk i është bindur urdhrit për të ndaluar automjetin, si dhe për shtetasin E. A., 31 vjeç, banues në Tiranë, pasagjeri në këtë automjet, për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpëthyesë dhe i municionit”, pasi gjatë kontrollit fizik iu gjet municion luftarak.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme procedurale.



◀ Policia e Shtetit/Njoftim për aplikimet në Akademinë e Sigurisë

Sarandë/Kundërshtuan punonjësit e Policisë dhe i penguan ata për kryerjen e detyrës, vihen në pranga 2 shtetas (vëllezër), njëri prej tyre i shpallur në kërkim ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent